

SHENIMET SHPJEGUESE

Sqarim:

Dhenia e shenimeve shpjeguese ne kete pjese eshte e detyrueshme sipas SKK 2 dhe SKK 15 per Mikronjesite.

Plotesimi i te dhenave te kesaj pjese duhet te behet sipas kerkesave dhe struktures standarte te percaktuara ne SKK 2 dhe konkretisht pragrafeve 49-55 dhe SKK 15. Rradha e dhenies se shpjegimeve duhet te jete:

- A) Informacion i pergjithshem dhe politikat kontabel.
- B) Shenimet qe shpjegojne zerat e ndryshem te pasqyrave financiare.
- C) Shenime te tjera shpjeguese.

A/I Informacion i Pergjithshem.

- 1) Kuadri ligjor : Ligji 9228, dt.29.04.2004 „ Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“.
- 2) Kuadri kontabel i aplikuar: Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi. (SKK 2; 49dhe SKK 15)
- 3) Baza e pergatitjes se PF: Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara. (SKK1; 37-69).
 - a) MIKRONJESIA EKONOMIKE RAPORTUESE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike te vetat.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te mikronjesise sone raportuese eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUESHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjithshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar per zera materiale.
 - f) BESUESHMERIA per hartimin e Pasyqrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhtme:
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparises se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore.
 - Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem.
 - Parimin e maturise pa optimizem te tepruar, pa nenvleresim apo mbivleresim te qellimshem.
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te

- Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel.

B) Shenime shpjeguese mbi zerat e pasqyrave kryesore

Sipas SKK 2 " Paraqitja e Pasqyrave Financiare " renditja e sqarimeve te vecante te pasqyrave financiare ne keto shenime jane bere ne perputhje me renditjen e tyre ne pasqyrat financiare.

Pasqyra e pozicionit financiar

Eshte pergatitur ne perputhje me SKK nr.15 dhe ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " i ndryshuar.

Konform SKK 15 " Objektivat dhe bazat e pergatitjes ", paragrafi 4, formati i bilancit eshte paraqitur i reduktuar nga zerat jomateriale.

Aktivi :

Ne piken 1 - Aktivet Monetare eshte gjendja e likuiditeve monetare ne banke ne dt. 30/04/2015 ne leke dhe ne euro e rivleresuar me kursin e dates 30/04/2015 perkatesisht 140.53 leke/euro.

Ne piken 3 - Te arketueshme nga shfrytezimi eshte shuma e prishme per t'u arketuar nga klientet Dhoma e Fasonisteve te Shqiperise ne shumen 136,000 leke dhe Agjensia Shqiptare e Zhvillimit te Investimeve ne shumen 910,800 leke.

Ne piken 5 - Shpenzime te shtyra eshte shuma 15,700 leke per sherbime interneti per t,u ngarkuar ne periudhen pas 30 Prill 2015.

Ne piken 8 - Mjete transporti eshte vlera e autoveturen e marre me qera financiare ne 30 Dhjetor 2011 nga Raiffeisen Leasing sh.a. Ky automjet eshte i paraqitur ketu me vleren neto pas zbritjes se amortizimit llogaritur per kete periudhe me normen 20%. Gjithashtu ne kete post eshte edhe vlera e disa asetave te tjera te paraqitura me vleren neto, amortizimi per te cilat eshte llogaritur 20 % per mobiljet e zyres dhe 25 % per pajisjet informatike. Shtesa e asetave te blera gjate kesaj periudhe eshte ne shumen 318,112 leke (mobilje per zyren).



Detyrimet :

Ne piken 13.2 - Overdraftet bankare per shumen 2,609 leke .

Ne piken 13.4 - Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit ne shumen 278,314 leke tepricat kreditore te llogarive te furnitoreve dhe kreditoreve te tjere dhe perkatesisht: Gigenet ne shumen 159,543,54 leke (1270.15 \$), Etleva Dhamo ne shumen 60,000 leke, OSHEE ne shumen 1,194 leke, te tjere kreditore ne vleren 9,730 leke dhe dhe fatura per qerane financiare te makine ne shumen 47,837,82 leke (340,41 euro).

Ne piken 13.8 - Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore ne shumen 675,275 leke : pagat 600,896 leke dhe sigurimet shoqerore e shendetesore ne shumen 74,379 leke.

Ne piken 13.9 - Te pagueshme per detyrimet tatimore jane perfshire tatimi mbi pagat ne shumen 41,901 leke, shuma e TVSH per t'u paguar ne shumen 39,990.73 leke.

Ne piken 13.10 - Te tjera te pagueshme shuma prej 1,090,582 leke vlera e likuideve te shtuara nga ortakut.

Ne piken 14 - Te pagueshme per shpenzime te konstatuara fatura e Vodafone konsum per muajin Prill 2015 ne shumen 23,835 leke.

Ne piken 17.2 - Detyrime ndaj institucioneve te kredise eshte shuma e mbetur nga kontrata e qerase me Raiffeisen Leasing SHA per autoveturen ne shume 556,633.71 leke ose 3,960.96 euro.

Kapitali:

Ne piken 23 - Kapitali i pronarit eshte vlera e kapitalit fillestar te derdhur ne momentin e krijimit te shoqerise

Ne piken 27-28 - Fitimi (humbja) e periudhes ushtrimore eshte rezultati financiar, pas tatim fitimit, nga ushtrimi i aktivitetit i cili per Janar - Prill 2015 ne shumen 1,527,357 leke dhe ne shumen 3,606,758 leke eshte rezultati i mbartur nga viti 2014, i cili me vendimin e ortakut ne Qershor 2015 eshte shperndare ne dividende dhe rezerva.



Pasqyra e Performances

Eshte pergatitur gjithashtu ne perputhje me SKK dhe ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " i ndryshuar.

Konform SKK 15 " Paraqitja e Pasqyrave Financiare " eshte perdorur formati me klasifikim te shpenzimeve sipas natyres.

Te ardhurat :

Ne piken 29 - Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit ne shumen 6,418,693 leke.

Ne piken 3 - Te ardhura te tjera te shfrytezimit ne shumen 654 leke eshte mbyllja e teprices kreditore e llogarise se klientit "Klinika Gjermane e Syrit".

Ne piken 38.3 - Te ardhura te tjera ne shumen 5,747 leke jane te ardhura nga kembimet valutore.

Shpenzimet :

Ne piken 34 - Shpenzime personeli eshte perfshire pagat e stafit te firmes si edhe shpenzimet per sigurime shoqerore.

Ne piken 36 - Amortizimi i AA llogaritur me normat ligjore dhe reduktuar vleres bruto te asetëve. Per mjetin e transportit 20 %, per mobiljet e zyres 20 % dhe per pajisjet informatike 25 %.

Ne piken 37 - Shpenzime te tjera shfrytezimi ne shumen 2,620,449 leke jane : shpenzime per web-hosting 492,251 leke, per karburant 202,300 leke, per qera zyre 65,940 leke, materiale e riparime per zyren ne shumen 68,071 leke, shpenzime per personel jashte firmes (sherbime per krijim aplikacioni, per konsulence kontabel) ne shumen 736,621 leke, sherbim reklame 280,540 leke, shpenzime te telefonise celulare 112,596 leke, komisionet bankare 28,164 leke, taksa lokale 10,120 leke, gjoba dhe demshperblime ne shumen 24,444 leke, shpenzime te tjera korente (te pashoqeruara me dokument justifikues) ne shumen 599,402 leke.



C) Shenime shpjeguese te tjera

Ne perputhje me **SKK 11** "Tatimi mbi Fitimin", paragrafi 40 sqarojme menyren e llogaritjes se detyrimit te tatim fitimit per periudhen ushtrimore Janar-Prill 2015:

Fitimi i vitit ushtrimor	1,701,779 leke
Shpenzimet e panjohura	623,846 leke
Fitimi i tatueshem	2,325,626 leke
Tatim fitimi	174,422 leke
Fitimi pas tatimit	1,527,357 leke



IMAGE & COMMUNICATIONS
DEVELOPMENT

Subjekti " Image & Communication Development " shpk

NIPT – L01511027P

Inventari I automjeteve (me qera financiare) te subjektit ne 2015

Nr.	Lloji i automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera
1	SUZUKI SX4	4 + 1	AA188CJ	2,053,500

Administratori

Igli Gjelishti

